

RREGULLAT E LOJËS SHPËRBLYESE

Rregullat zyrtare të lojës shpërblyese "#ProVozitu me ProCredit Bank dhe Mastercard!"

ORGANIZATOR

Neni 1

Organizator i lojës shpërblyese "#ProVozitu me ProCredit Bank dhe Mastercard!" është ProCredit Bank SHE Shkup me seli të regjistruar në rr. MANAPO nr.7, 1000 Shkup, NUAS (EMBS): 5774136 dhe NUT (EDB): 4030003482066 (në tekstin e mëtejshëm Organizatori).

EMRI ZYRTAR DHE KOHËZGJATJA E LOJËS SHPËRBLYESE

Neni 2

Emri zyrtar i lojës shpërblyese është "#ProVozitu me ProCredit Bank dhe Mastercard!". Loja shpërblyese do të fillojë më 19.05.2023 (duke filluar nga ora 00:01) dhe do të zgjasë deri më 30.09.2023 (deri në orën 23:59).

TERRITORI

Neni 3

Loja shpërblyese organizohet dhe zhvillohet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

SUBJEKT I REKLAMIMIT ME LOJËN SHPËRBLYESE

Neni 4

Loja shpërblyese organizohet me qëllim të promovimit të përbashkët të ProCredit Bank SHA Shkup dhe Mastercard, gjegjësisht reklamim i llogarive për pagesa dhe karta debiti Mastercard për persona fizikë që lëshohen përmes ProCredit Bank SHA Shkup.

REKLAMIMI

Neni 5

Loja shpërblyese do të reklamohen nëpërmjet aktiviteteve ATL (Radio, Media Sociale dhe Kanalet Digjitale, Marketing Influencer, Video Marketing, Ueb Marketing) dhe aktivitetet BTL (Marketing PR, Evente dhe Promocione).

REKLAMA E PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE PËR TË CILAT ORGANIZOHET LOJA SHPËRBLYESE

Neni 6

Produktet për të cilat reklamohet loja shpërblyese janë llogaritë për pagesa për persona fizikë të ProCredit Bank SHA Shkup dhe kartat e debitit MASTERCARD, të cilat lëshohen së bashku me rastin e hapjes së llogarisë për pagesa nga personi fizik në ProCredit Bank SHA Shkup.

E DREJTA PËR PJESËMARRJE

Neni 7

Të drejtë për pjesëmarrje në lojën shpërblyese "#ProVozitu me ProCredit Banka dhe Mastercard!" kanë të gjithë personat fizikë mbi moshën 18 vjeç, të cilët do të bëhen klientë të rinj të bankës duke hapur një llogari për pagesë për personat fizikë në ProCredit Bank SHA Shkup dhe do të kryejë së paku 5 transaksione me kartelën e debitit nga ProCredit Bank SHA Shkup në periudhën prej 19.05.2023 - 30.09.2023. Punonjësit e Organizatorit dhe punëtorët e PIXEL DOO Shkup, gjithashtu si anëtarë të familjes së tyre të ngushtë, nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në lojën shpërblyese. Duke marrë pjesë në lojën shpërblyese, pjesëmarrësit konfirmojnë se janë plotësisht të njohur me dispozitat e këtyre rregullave dhe shprehin se pajtohen me to.

KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË LOJËN SHPËRBLYESE

Neni 8

"#ProVozitu me ProCredit Bank dhe Mastercard!" është lojë shpërblyese që do të realizohet në hapësirat e Organizatorit, por në nivel rajonal të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Çdo person i interesuar (i përmendur në nenin 7) për të marrë pjesë në lojën shpërblyese, duhet të bëhet klient i ri i bankës duke hapur një llogari pagese për persona fizikë në ProCredit Bank SHA Shkup dhe të kryejë së paku 5 transaksione me kartelën e debitit Mastercard nga ProCredit Banka SHA Shkup në periudhën prej 19.05.2023 deri më 30.09.2023.

Në periudhën derisa zgjatë loja shpërblyese, një pjesëmarrës mund të fitojë vetëm një shpërblim gjatë shortit.

Informacionet e pjesëmarrësve të lojës shpërblyese, të cilat përmbajnë të dhëna të pasakta, të paplota ose të pavlefshme (emër, mbiemër dhe numër telefoni) nuk do të merren parasysh dhe nuk do të marrin pjesë në tërheqjen e shortit të lojës shpërblyese. Pjesëmarrësi, i cili nuk i plotëson kushtet e tjera për pjesëmarrje (nëse transaksionet nuk janë përfunduar brenda periudhës së caktuar kohore ose pjesëmarrësi nuk e plotëson kufirin e moshës, etj.) do të skualifikohet nga Loja shpërblyese dhe do të humbasë të drejtën për të marrë shpërblim.

Organizatori i lojës shpërblyese e mban të drejtën të refuzojë të gjitha transaksionet për pjesëmarrje që është fituar në mënyrë jo legjitime, janë riprodhuar, të dyfishuara, të fabrikua ose modifikuar në çfarëdo mënyre.

Rregullat e lojës shpërblyese, mënyra dhe kushtet për pjesëmarrje në lojën shpërblyese, si dhe kohëzgjatjen e saj, organizatori do t'i publikojë në faqen zyrtare të ProCredit Bank SHA Shkup para fillimit të lojës shpërblyese, e pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Financave.

TËRHEQJA E FITUESVE NË LOJËN SHPËRBLYESE

Neni 9

Fituesit e shortit do të tërhiqen drejtpërdrejt në prani të përfaqësuesve të ProCredit Bank SHA Shkup, përfaqësues i Pixel SHPK Shkup dhe një Noter.

Duke filluar nga data 19.05.2023 (duke filluar nga ora 00:01) dhe duke përfunduar me 30.09.2023 (deri në ora 23:59) shorti i shpërblimeve zgjat 4 muaj e gjysmë (katër e gjysmë).

Në lojën shpërblyese do të tërhiqen 20 fitues të shpërblimeve të mëposhtme:

	Lloji i shpërblimeve	Numri i shpërblimeve
1	Biçikletë MBM Central Lady	20

Shorti i shpërblimeve do të mbahet dy herë, me dy tërheqje. Në çdo tërheqje do të ndahen nga 10 (dhjetë) shpërblime - biçikleta.

Tërheqja e shortit për shpërblimet do të mbahet në datat 19.07.2023 dhe 02.10.2023 në ora 12:00 në ambientet e selisë së organizatorit të lojës shpërblyese.

Në tërheqjen e shortit, që do të mbahet më 19.07.2023, do të marrin pjesë ata të cilët janë bërë klientë të rinj të bankës duke hapur llogarinë e pagesës për persona fizikë në ProCredit Bank SHA Shkup dhe kanë kryer së paku 5 transaksione me kartën e debitit Mastercard nga ProCredit Bank SHA Shkup jo më vonë se 18.07.2023. Pjesëmarrësit që nuk janë fitues të shpërblimit nga shorti i parë, vazhdojnë të marrin pjesë në shortin e dytë, i cili do të mbahet më 02.10.2023, së bashku me pjesëmarrësit e rinj.

Gjatë shortit të shpërblimeve, për secilin fitues të tërhequr do të tërhiqen edhe dy fitues alternativ. Nëse shfaqet pengesë për dhënien e shpërblimit, shpërblimi do t'i jepet fituesit të parë rezervë, dhe nëse ka ndonjë pengesë tjetër për dhënie, shpërblimi do t'i jepet fituesit të dytë rezervë.

Mënyra e tërheqjes së fituesve do të kryhet nëpërmjet zgjidhjes së brendshme të sistemit të Organizatorit, përmes së cilës vetëm pjesëmarrësit e kualifikuar që i plotësojnë kushtet e lojës shpërblyese do të veçohen/përzgjidhen në një skedar elektronik të veçantë, nga i cili do të përzgjidhen në mënyrë të rastësishme gjegjësisht do të tërhiqen, fituesit e shpërblimeve. Zgjidhja e brendshme e sistemit për përzgjedhjen e fituesve do të bëhet në formë raporti. Gjenerimi i të dhënave do të mundësohet nëpërmjet sistemit bazë bankar të ProCredit Bank SHA Shkup. Punonjësit e bankës që janë anëtarë të komisionit të jurisë do të kenë privilegjin të gjenerojnë të dhënat përmes kompjuterëve të tyre zyrtarë. Kompjuterët zyrtarë ma anë të të cilëve akses kanë personat me privilegje për gjenerim të të dhënave ndodhen në selinë e ProCredit Bank, në rr. Manapo nr.7, Shkup.

Tërheqja (shorti) në këtë mënyrë do të bëhet direkt (live) dhe në prani të Komisionit Juri. Komisioni juri do të përbëhet nga përfaqësuesit në vijim:

1. 2 (dy) përfaqësues nga ProCredit Bank SHA Shkup, 1 përfaqësues nga Pixel SHPK Shkup, si dhe noter me seli zyrtare në zonën e gjykatave themelore të qytetit të Shkupit;

SHPALLJA E REZULTATEVE TË LOJËS SHPËRBLYESE Neni 10

Fituesit e shpërblimeve nga çdo short (tërheqje) do të shpallen brenda 3 ditëve nga shorti në faqen e internetit <https://www.pcb.mk/> në një rubrikë të veçantë të faqes së krijuar për këtë qëllim, duke i publikuar emrat dhe mbiemrat e fituesve. Gjithashtu, fituesit do të njoftohen me SMS ose mesazh Viber, në numrin e telefonit të specifikuar.

NJOFTIMI I FITUESVE Neni 11

Pas çdo shorti (tërheqjeje), fituesi do të marrë një mesazh SMS/Viber në numrin e telefonit të dhënë me përmbajtjen e mëposhtme:

"Urime për fitimin e shpërblimit, prisni që t'Ju kontaktojmë për ta marrë atë. Nëse nuk jeni në dispozicion për kontakt në 30 ditët e ardhshme, ju e humbni të drejtën për të marrë shpërblimin."

Nëse pjesëmarrësi nuk është në dispozicion brenda 30 ditëve të ardhshme për çfarëdo arsye, për të cilën Organizatori nuk është dhe nuk do të jetë përgjegjës, ai/ajo e humb të drejtën e shpërblimit. Organizatori nuk do të ketë asnjë përgjegjësi shtesë ndaj pjesëmarrësit.

NDARJA E SHPËRBLIMEVE Neni 12

Shpërblimet do të ndahen jo më shumë se 60 ditë nga tërheqja e shortit për ta. Pas kalimit të këtyre 60 ditëve Organizatori nuk mban asnjë përgjegjësi për shpërblimet.

Fituesit nuk mund të shkëmbejnë shpërblimet e tyre për para të gatshme të barabarta me vlerën e tyre ose për ndonjë artikull tjetër. Fituesit do të duhet t'i marrin shpërblimet personalisht në lokalet e ProCredit Bank SHA Shkup, çdo ditë pune nga e hëna deri të premten.

KUSHTET PËR MARRJEN E SHPËRBLIMEVE Neni 13

Fituesi do të mund të marrë shpërblimin duke paraqitur një dokument për identifikim personal.

Nëse fituesi, për çfarëdo arsye, nuk mund të paraqesë dëshmi/dokument për identifikim personal, në atë rast ai nuk do të mund ta marrë shpërblimin.

Nëse fituesi nuk është në gjendje të marrë shpërblimin për ndonjë arsye, ai mund të caktojë një person për ta bërë këtë në emër të tij, me njoftim paraprak te Organizatori, por vetëm me autorizim me shkrim nga fituesi, i vërtetuar nga një noter.

Nëse fituesi e anulon marrjen e shpërblimit për ndonjë arsye, ai është i detyruar të njoftojë Organizatorin.

Gjatë marrjes së shpërblimit, do të nënshkruhet një vërtetim se shpërblimi është marrë nga fituesi.

Organizatori është i detyruar të kontrollojë nëse janë plotësuar të gjitha kushtet për pjesëmarrje dhe nëse fituesi i plotëson të gjitha kushtet për marrjen e shpërblimit, sipas rregullave. Pas dorëzimit të shpërblimit, Organizatori nuk ka asnjë përgjegjësi ndaj fituesit të shpërblimit në lidhje me përdorimin e tij, me përjashtim të përgjegjësive të përcaktuara në rregullore. Organizatori nuk mban përgjegjësi për dorëzimin e shpërblimit në adresën e Fituesit dhe nuk do të mbulojë asnjë kosto shtesë, si shpenzimet e transportit apo të llojeve të tjera (për shembull: sigurimi i biçikletës, ose çdo lloj kosto shtesë, etj.), kostot e realizimit që janë nuk përshkruhen në rregulla ose në kontratë të nënshkruar veçmas ndërmjet Organizatorit dhe fituesit.

Organizatori nuk mban përgjegjësi nëse fituesi nuk është në gjendje të marrë shpërblimin brenda afatit të caktuar.

Rezultatet për shpalljen e fituesve janë përfundimtare.

FONDI I SHPËRBLIMEVE Neni 14

Loja shpërblyese ka në dispozicion grupin e mëposhtëm shpërblimesh (20 gjithësej) Biçikleta MVM SEITVA1 ^A^U.

Fondi i përgjithshëm shpërblyes për këtë lojë shpërblyese me TVSH është 563.200 denarë.

	LLOJI I SHPËRBLIMIT	Sasia	Shpërblimi për një shpërblim me TVSH	Vlera totale e shpërblimeve me TVSH
1	Biçikletë MBM Central Lady	20	28.160,00 denarë	563.200,00 denarë

Sasi e shpërblimeve të Lojës shpërblyese është e kufizuar dhe nuk do të jepen më shumë shpërblime se ato që janë përcaktuar më parë. Zëvendësimi i shpërblimeve me shpërblime të tjera, me vlerë monetare ose barsvlerë tjetër, nuk lejohet. Organizatori nuk merr përsipër të ofrojë një lloj tjetër shpërblimi në të njëjtën kundërvlerë të shpërblimeve të planifikuara. Pjesëmarrësit në lojën shpërblyese nuk kanë të drejtë të kërkojnë shpërblime të një vlere më të lartë ose të një lloji të ndryshëm nga ato të përcaktuara në rregullat nga Organizatori.

VERIFIKIMI PËR KUALIFIKIM DHE TË DREJTË PËR PJESËMARRJE Neni 15

Shpërblimi do të jepet vetëm nëse pjesëmarrësit janë të kualifikuar, kanë të drejtë për të marrë pjesë dhe nëse i respektojnë plotësisht Rregullat e Lojës shpërblyese.

DETYRIMET TATIMORE TË FITUESVE TË SHPËRBLIMEVE Neni 16

Organizatori është përgjegjës për të gjitha tatimet, tarifat dhe detyrimet që lidhen me shpërblimet duke përfshirë tatimin mbi të ardhurat personale.

Secili nga fituesit do të marrë një faturë për fitimet me tatimin mbi të ardhurat personale të paguar, të përgatitur dhe të vërtetuar nga Organizatori i lojës shpërblyese.

PËLQIMI PËR PËRDORIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE DHE TË PRIVATËSISË Neni 17

Me rastin e hapjes së llogarisë për pagesë, Pjesëmarrësit në lojën shpërblyese do t'i paraqitet një njoftim për privatësi në lidhje me të dhënat që do të përpunohen në lojën shpërblyese, me informacion për pëlqimin që duhet të japin për të marrë pjesë në lojë.

Pas pranimit të të gjitha informacioneve të nevojshme për të dhënat personale që do t'i nënshtrohen përpunimit, me pjesëmarrjen në lojën shpërblyese, Pjesëmarrësi do të jetë në gjendje të marrë një vendim të informuar për të dhënë pëlqimin e nevojshëm për përpunimin e të dhënave personale.

Informacionet që kanë të bëjnë me të dhënat personale, së bashku me rregullat e lojës shpërblyese dhe njoftimin e privatësisë, për kohëzgjatjen e lojës shpërblyese do të shpallen në <https://www.pcb.mk/provozise>.

E DREJTA PËR KUNDËRSHTIM Neni 18

Çdo pjesëmarrës i cili është i pakënaqur me mënyrën se si zhvillohen dhe përzgjidhen fituesit e Lojës shpërblyese, ka të drejtë të paraqesë një kundërshtim me shkrim te Organizatori, brenda 3 ditësh nga dita e shpalljes së fituesve të shpërblimeve nga shorti. Pjesëmarrësi i pakënaqur mund ta paraqesë kundërshtimin në adresën elektronike: mkd.info@procredit-group.com. Organizatori është i detyruar t'i përgjigjet me shkrim kundërshtimit brenda 8 ditësh nga pranimi i tij. Pjesëmarrësi do të pranojë përgjigjen për kundërshtimin në adresën elektronike nga e cila e ka dërguar kundërshtimin.

ANULIMI I SHPËRBLIMIT Neni 19

Loja shpërblyese mund të ndërpritet vetëm nëse ndodhin rrethana për të cilat organizatori i lojës shpërblyese nuk mban përgjegjësi, gjegjësisht nëse ekzistojnë rrethana të cila Organizatori nuk ka mundur t'i parandalojë, largojë ose shmangë në përputhje me nenin 9 të Ligjit për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese. Nëse shfaqen rrethana të tilla, ato menjëherë do të shpallen në faqen zyrtare të ProCredit Bank SHA Shkup.

ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE TË MUNDSHME Neni 20

Në rast të kontestit ndërmjet Organizatorit dhe pjesëmarrësve në lojën shpërblyese, ato do të

zgjidhen në mënyrë miqësore. Nëse Organizatori dhe pjesëmarrësit e lojës shpërblyese nuk ia dalin të arrijnë marrëveshje të ndërsjellë për zgjidhjen e kontestit, kompetente do të jetë Gjykata Themelore Civile në Shkup, në pajtim me rregulloret në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

VLEFSHMËRIA E RREGULLAVE TË LOJËS SHPËRBLYESE
Neni 21

Rregullat do të publikohen në faqen zyrtare të ProCredit Bank SHA Shkup para fillimit të lojës shpërblyese, e pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Financave. Ato do të fillojnë të aplikohen pasi Ministria e Financave të lëshojë licencën për organizimin e lojës shpërblyese dhe do të jenë të vlefshme deri në përfundimin e lojës shpërblyese. Me pjesëmarrjen në Lojën shpërblyese, konsiderohet se çdo pjesëmarrës pajtohet dhe i pranon pa kushte të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këto rregulla.

Shkup, më 3 maj 2023,

Për organizatorin,

ProCredit Bank SHA Shkup

